# DËSHMI ARKIVI

**A-469452**
VERSIONI 2

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Nga Dubai në Belgjikë, i hapet rrugë ekstradimit të trafikantit shqiptar Eldi Dizdari, dy ditë më parë u arrestua shoku i tij (DETAJE) |
| ADRESA | `https://newsbomb.al/aktualitet/dy-dite-pas-bashkepunetorit-te-tij-prangoset-ne-dubai-trafikanti-shqi-i402040` |
| BURIMI | newsbomb.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 15:52:00 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 15:46:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `66ebb82e3443020588dbb99185dc13a7a21a05695838e238b87e25343b13b904` |
| TEKSTI | `a83ed1b86dda27492112916bea531972f4eb452c13627b53534bbea5ccf227bb` |
| PAMJA | `c17c05e0e38f36eab342694aba3a2b12a7e4b926a248caf4e8063c98feb7d3cf` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4b0f99755dbdbc21b2310dfd1c4012c7efb06cd2a0d078a341068a75fe950a2b` |
| E MËPARSHMJA | `39854cfa1838e70aee018c7c7fcf23a32ae54a9021337332429faa10e7ef0647` |
| RRËNJA MERKLE | `77d68db3023b2e51e8611bf6d5eddb24bf36cfc38da7912fff4d1353a313a25f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4b0f99755dbdbc21b2310dfd1c4012c7efb06cd2a0d078a341068a75fe950a2b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese



Aktualitet

25 Shtator 2026, 17:46

# Nga Dubai në Belgjikë, i hapet rrugë ekstradimit të trafikantit shqiptar Eldi Dizdari, dy ditë më parë u arrestua shoku i tij (DETAJE)

Shkruar nga **Newsbomb**



Ne foto: Eldi Dizdari

Eldi Dizdari alias Denis Matoshi, trafikanti shqiptar pjesë e trafikimit të drogës nga Amerika Latine raportohet se do të ekstradohet nga Emiratet e Bashkuara Arabe drejt Belgjikës, pas përfundimit të procedurave të gjata ligjor mes dy vendeve.

Lajmin e ka bërë me dije **Gazet van Antwerpen**, e cila shkruan se prokuroria vendase e cila ka konfirmuar vendimin, ndërsa 37-vjeçari Matoshi pritet të niset drejt Belgjikës aty ku dhe do të vuajë dënimin e dhënë nga gjykata e Antwerp-it.

Denis Matoshi i njohur ndryshe dhe me emrin Eldi Dizdari, për të cilin shpesh përdoret dhe nofka "shqiptari i gjatë", konsiderohet nga belgët si një ndër personat që ka pasur në dorë drejtimin e organizatën kriminale të njohur me emrin "Kompania Bello".

Autoritetet belge i kanë atribuar "Kompanisë Bello" lidhje me një rrjet ndërkombëtar të trafikut të kokainës. Prej vitesh çështja është hetuar dhe ndjekur me vëmendje nga autoritetet e huaja. Kështu ekstradimi i Eldi Dizarit vjen pas një procesi të zgjatur juridik në Emiratet e Bashkuara Arabe.

Ashtu siç kemi raportuar dhe ne më parë, Denis Matoshi, i njohur edhe si Eldi Dizdari, kërkohet edhe nga drejtësia në Shqipëri, pasi Prokuroria e Posaçme e akuzon atë si pjesë e grupit kriminal "Kompania Bello" i formuar nga rreth 14 klane kriminale shqiptare të cilat bashkëpunim për të mbushur me "pluhur të bardhë" me origjinë nga Amerika Latine,

Revista




Abonohu tani dhe lexoje

## Lajmet e fundit


Politikë
100 apo 15 bashki? Demokratët e socialistët bëjnë lëvizjen e radhës, PD i dërgon draft ligjin Kuvendit, mazhoranca kërkon aprovimin e Peleshit


Politikë
Edi Rama nga New York: Joe Biden e tradhtoi Hashim Thaçin, SHBA nuk bëri më të mirën për të

Zbulo më shumë artikuj

vende të shumta të Europës.

Kujtojmë se para dy ditësh është në pranga së fundmi një nga personat më të kërkuar të SPAK, trafikanti i kokainës Shpëtim Aliu, një prej figurave kyçe të një rrjeti të fuqishëm të trafikut ndërkombëtar të kokainës, i njohur ndryshe me nofkën "Salvadore", pjesë e grupit të Eldi Dizdarit.


Këshilluar për ty



**GJKKO e do në burg për trafikimin e dhjetërave ton kokainë, PRANGOSET në Rusi i shumëkërkuari Shpëtim Aliu, "shoku" i Eldi Dizdarit pritet t'i dorëzohet Shqipërisë (DETAJE)**


Në sajë të hetimeve të kryera për zbardhjen e episodeve të ndryshme të trafikimit të kokainës nga grupi i Eldi Dizdarit, në qershorin e këtij viti SPAK njoftoi se janë dokumentuar pesë episode të mëdha nga ku janë sekuestruar në total afro 9 ton lëndë narkotike. Mes tyre spikasin ngarkesa prej 4.1 tonësh kokainë në portin e Roterdamit, mbi 2 ton në Ekuador, si dhe sasi të tjera të konsiderueshme të kapura në Belgjikë, Holandë dhe Kolumbi.

Sipas prokurorëve të posaçëm, fitimet e siguruara nga trafiku i drogës janë transferuar më pas në Shqipëri dhe janë investuar në kompani ndërtimi, hoteleri, pasuri të paluajtshme dhe aktivitete të tjera tregtare me qëllim fshehjen e origjinës së tyre kriminale.

Në kuadër të operacionit është urdhëruar një nga sekuestrimet më të mëdha pasurore të viteve të fundit. Me vendim të Gjykatës së Posaçme janë vendosur nën sekuestro preventive plot 491 pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, të cilat dyshohet se burojnë nga aktiviteti kriminal i grupit.

Bëhet fjalë për dhjetëra kompani, qindra prona, vila luksoze, apartamente, njësi tregtare, hotele, toka, automjete, mjete lundruese dhe 209 llogari bankare. Mes pasurive të sekuestruara përfshihen prona në Tiranë, Durrës, Gjirin e Lalzit, Himarë, Sarandë, Shkodër, Lezhë dhe qytete të tjera të vendit.

Ndër asetet më të rëndësishme të vendosura nën sekuestro janë dhjetëra vila dhe apartamente në komplekse elitare, struktura hotelerie në zonat turistike të bregdetit, si dhe objekte me vlerë të lartë në kryeqytet.

Sipas SPAK, vlera paraprake e pasurive të sekuestruara llogaritet rreth 150 milionë euro, ndërsa verifikimet vijojnë për përcaktimin e vlerës së saktë të tyre.

## Sondazh

Poll

## Lexo gjithashtu



E Premte 18:07

## Pas SKANDALIT me Ergys Agasin, SHISH “zhduk” Vlora Hysenin (DETAJI)



Aktualitet

“Kokë më kokë” me Arbena Ahmetin, gjyqtari Sandër Simoni siguron karrigen në KLGJ, hedhja e shortit i jep fitoren (DETAJE)

E Premte 17:59 Newsbomb



Aktualitet

Vuno shpallet “Qendër Historike”, Qeveria miraton zonën e mbrojtur dhe planin e administrimit

E Premte 17:21




E Premte 16:43

## U qëllua me vezë nga shqiptarët në New York, Rama dy fjalë për protestuesit: Pulat histerike të katundit tonë kakarisin, s’do të më ndalni me baltë e jargë




Aktualitet

DALIN PAMJET! Si u vra në mes të Sarandës Artan Myrtaj, atentatori e ndoqi me vrap për disa metra dhe e ekzekutoi nga afër

E Premte 15:39



Aktualitet

Gjenerali Eric Wendt shkel në tokën shqiptare, ambasadori i ri amerikan mbërrin në Tiranë (AXHENDA)

E Premte 15:27






E Premte 15:03

## Plagosje me armë zjarri te "Zogu i Zi", një shtetas nga Kosova dërgohet me urgjencë te Trauma (DETAJET E PARA)



Aktualitet

"Nuk do t'i lëmë të na bëjnë të fortin", si degradoi nga TikTok-u sherri mes të miturve në Yzberisht, mblodhën shokët dhe shkuan të "sqarohen"

E Premte 13:58



Aktualitet

Turistja çeke dhe i dashuri i saj humbin bagazhet në autobusin e Shkodrës, denoncojnë në internet "Kompaninë BERISHA": Çantat tona ranë rrugës, kur na i kthyen ishin të hapura (FOTO)

E Premte 13:44




E Premte 13:35

## Parandalohet tragjedia në Yzberisht, 23 të mitur shkojnë të rrihen me njëri-tjetrin, me vete kishin shkopa bejsbolli, blutë e 6-tës ndërhynë menjëherë



Aktualitet

NUK KA MË SEKRETE! Sali Berisha nxjerr FOTON e drejtorit të Operacionales në SHISH dhe shkruan: Te lokali i tij në



Aktualitet

Vlora Hyseni nën akuzë në Shqipëri, mediat në Rumani japin ALARMIN: Është stërvitur nga Gjenerali i Zi,




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.